



Republika E Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	06.10.20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	01-370/01-25036/20	Shtojcë	

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Konz. "REMA KOMPANY" shpk & NTSH "REMA:", nga Kaçaniku përfaqësuar nga Arbër Guri (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Rregullimi i trotuarit në lagjen Topall - Soponicë

me numër identifikues: **KA652/20/065/521**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Rregullimi i trotuarit në lagjen Topall - Soponicë

në <sipas dosjes> pjesë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total është **22,767.53 €**,

dhe me fjalë (Njëzetëedymijëeshtatëqindëegjashtëdhjetëeshtatëeuro e 53/100 centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arbër Guri	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	06.10.2020	Data:	06.10.2020
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE] .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat] ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat] ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat] ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [shëno numrin] ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [shëno numrin] ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: Valmir Krasniqi
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë prej 08.19.2020 ku e gjithë plani artohet në ditarë ndërtimor.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë brenda 30 ditëve .
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuuese e defekteve është 365 ditë (një vit) nevlere prej 10 % të vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.25 %] për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha

		Punët është 20 % e Çmimit final të Kontratës.
Kushtet e pagesës	20.1	Kushtet e pagesës janë: Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <u>[shëno përqindjen]</u>
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 2,276.75€
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <u>[shëno përqindjen]</u>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore, në rast se nuk zgjidhet në mënyrë miqësore kompetente është Gjykata komunale Kaçanik.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<u>[shëno të dyja]</u> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komunale Kaçanik b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <u>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</u> në pajtim me <u>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</u>

PARAMASA ME PARALLOGARI					
Ndërtimii trotuarit ne lagjen Topalli					
Nr.	Lloji I punës	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Punët paraprake				
1.1	Pastrimi i terenit, prerja e drunjëve dhe shkurreve, largimi i mbeturinave, demolimi i kubëzave të betonit, demolimi dhe thyerja betonit, të gjitha këto përgjatë trotuarit, me bartje të materialit deri në deponi.	m'	870.00	0.10 €	87.00 €
2.1	Prerja e asfaltit sipas nevojës, për rregullimin e vijës së trotuarit, me bartje të materialit deri në deponi.	m'	250.00	0.10 €	25.00 €
Punët paraprake				Gjithsej:	112.00 €
2	Punët tokësore				
2.1	Gërmimi i dheut dhe shtresave të forta të konstruksionit të rrugës ekzistuese me mekanizëm, me bartje të materialit deri në deponi.	m ³	469.80	0.60 €	281.88 €
2.2	Ngjeshja e nënbazës së trotuarit me makina përkatëse deri në 30 Mpa.	m ²	1305.00	0.10 €	130.50 €
2.3	Hapja e kanaleve atmosferike me mekanizëm, me bartje të materialit të deri në deponi.	m'	280.00	0.10 €	28.00 €
Punët tokësore				Gjithsej:	440.38 €
3	Punët e zhavorit				
3.1	Furnizimi me material, transporti, shtrirja dhe nivelizimi i shtresës nga materiali mbushës 0-150 mm, me ngjeshje me makina përkatëse deri në Mv=50 Mpa.	m ³	144.00	2.50 €	360.00 €
3.2	Furnizimi me material, transporti, shtrirja dhe nivelizimi i shtresës së tamponit prej zhavorit 0-63 mm, me trashësi 20 cm, në gjendje të ngjeshur, me ngjeshje me makina përkatëse deri në Mv=60 Mpa.	m ³	261.00	3.00 €	783.00 €
3.3	Furnizimi me material, transporti, shtrirja dhe nivelizimi i shtresës së tamponit prej zhavorit 0-31.5 mm, me trashësi 10 cm, në gjendje të ngjeshur, me ngjeshje me makina përkatëse deri në Mv=60 Mpa.	m ³	130.50	3.00 €	391.50 €
3.4	Furnizimi me material, transporti, shtrirja dhe nivelizimi i shtresës së tamponit prej zhavorit ose prej materiali rrethorë, për punimin e bankinave anash trotuarit.	m ³	52.20	3.00 €	156.60 €
Punët e zhavorit				Gjithsej:	1,691.10 €

4	Muret mbrojtëse				
4.1	Gërmimi i dheut dhe shtresave të forta për hapjen e themeleve të mureve me bartje të materialit deri në deponi.	m ³	12.00	1.00 €	12.00 €
4.2	Furnizimi me material, shtrirja, nivelizimi dhe ngjeshja e zhavorit nën themelet e mureve mbrojtëse, me trashësi 20 cm, në gjendje të ngjeshur.	m ³	4.00	3.00 €	12.00 €
4.3	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve dhe mureve nga betoni i klasës C30/37, së bashku me punën e kallëpeve, punimin e fugave të dilatimit dhe gypat PVC Ø50 mm për shkarkimin e ujërave atmosferik.	m ³	10.50	50.00 €	525.00 €
4.4	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe montimi i armaturës për armimin e themeleve dhe mureve mbrojtëse.	kg	682.50	0.40 €	273.00 €
Muret mbrojtëse			Gjithsej:	822.00 €	

5	Elementet e betonit				
5.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubëzave të betonit me trashësi $t=8$ cm. Kubëzat duhet të jenë me rezistencë në çarje prej 3.6 Mpa, konform standardit EN 1338. Në këtë pozicion hyn edhe punimi i shtresës së rrës nën kubëza me trashësi 4 cm (furnizimi dhe transporti), ngjeshja e tyre pas montimit me mekanizëm përkatës, mbulimi i fugave me rrës dhe pastrimi përfundimtarë i tyre. Lloji dhe dizajni i kubëzave të caktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	1120.98	7.70 €	8,631.55 €
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i anësoreve të betonit 18/24 cm. Anësoret duhet të jenë të klasës T me rezistencë në përkulje prej 5 Mpa, konform sipas standardit EN 1340. Në këtë pozicion hyn edhe punimi i shtresës së zhavorit dhe baza e betonit nën anësore (furnizimi dhe transporti).	m'	845.00	5.50 €	4,647.50 €
5.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i anësoreve të betonit 8/20 cm. Në këtë pozicion hyn edhe punimi i shtresës së zhavorit dhe baza e betonit nën anësore (furnizimi dhe transporti)	m'	870.00	3.30 €	2,871.00 €
Punët e asfaltit			Gjithsej:	16,150.05 €	

6	Kanalizimi atmosferik			
---	-----------------------	--	--	--

6.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave nga betoni i armuar me qafë, me diametër Ø500 mm, për vazhdimin e lëshesës ekzistuese. Në këtë pozicion përfshihen këto aktivitete: Demolimi i kokës dalëse ekzistuese, gërmimi i kanalit me bartje të materialit deri në deponi, mbështjellja e gypit me rërë $t=15$ cm dhe mbulimi i kanalit me zhavor (furnizimi dhe transporti) duke e bërë ngjeshjen në shtresa.	m'	80.00	15.00 €	1,200.00 €
6.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i kokave dhe dalëse nga betoni i armuar, të lëshesave të vazhduara. Betoni i klasës C30/37 Mpa dhe armatura S500. Kokat të punohen sipas detalit të dhënë.	copë	4.00	20.00 €	80.00 €
Kanalizimi atmosferik				Gjithsej:	1,280.00 €

7	Punët e ndriçimit publik				
7.1	Furnizimi me material dhe betonimi i bazës së shtyllave të ndriçimit publik me beton të klasës C25/30. Baza e shtyllave është me dimensione 80x80x80 cm. Në këtë pozicion hyn: gërmimi i gropës së themelit me bartje të materialit deri në deponi, shtrimi me zhavor 10 cm (furnizimi dhe transporti) si dhe montimi i gypit HDPE me diametër Ø250 mm (furnizimi dhe transporti) për mbjelljen e shtyllës.	copë	16.00	20.00 €	320.00 €
7.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i shiritit për vërejtje nga PVC me gjerësi 60 mm.	m'	900.00	0.10 €	90.00 €
7.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypit të brinjëzuar Ø50 mm. Në këtë pozicion hyn edhe mbështjellja e gypit me rërë (furnizimi dhe transporti).	m'	900.00	0.50 €	450.00 €
7.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit të zinkuar FeZn (20x3)mm.	m'	900.00	1.00 €	900.00 €
Punët e ndriçimit publik				Gjithsej:	1,760.00 €

8	Punët e tjera				
8.1	Furnizimi me material dhe betonimi i pjesës në mes të asfaltit dhe anësoreve të betonit, nga betoni i kualitetit C30/37. Në sipërfaqe betoni duhet të jetë i rrafshuar mirë dhe i lëmuar.	m'	620.00	0.30 €	186.00 €
8.2	Furnizimi me material dhe nivelizimi i pusetave deri në nivelin e rrugës.	copë	5.00	15.00 €	75.00 €

8.3	Furnizimi dhe montimi i kapakëve të gizës me aftësi mbajtëse 25 t.	copë	5.00	50.00 €	250.00 €
8.4	Dislokimi i shtyllave elektrike me të gjitha instalimet. Dislokimi duhet të bëhet në koordinim me KEDS dhe sipas standardeve të tyre.	copë	1.00	1.00 €	1.00 €
Punët e tjera				Gjithsej:	512.00 €

REKAPITULIMI

1	Punët paraprake	112.00 €
2	Punët tokësore	440.38 €
3	Punët e zhavorit	1,691.10 €
4	Muret mbrojtëse	822.00 €
5	Elementet e betonit	16,150.05 €
6	Kanalizimi atmosferik	1,280.00 €
7	Punët e ndriçimit publik	1,760.00 €
8	Punët e tjera	512.00 €
Gjithsej:		22,767.53 €

Vërejte!

Të gjitha çmimet e pozicioneve janë të llogaritura me TVSH.

Në të gjitha pozicionet nënkuptohet furnizimi dhe transporti i të gjitha materialeve duke e llogaritur edhe punën për realizimin e pozicionit, më të gjitha elementet përcjellëse.

Të gjitha materialet para përdorimit duhet të prezentohen për miratim nga organi mbikqyrës.

Punëkryesi duhet që me kujdes të realizoj punën, pasi për çdo dëmtim të instalimeve (ujësjetës, kanalizimit, trymës, etj.), i bartë shpenzimet për rregullimin e defekteve eventuale.

Punëkryesi i bartë shpenzimet për të gjitha atestet e materialeve dhe ekzaminimeve të cilat nevoiten në këtë rast dhe atestet dhe ekzaminimet shtesë të cilat kërkohen nga organi mbikqyrës.

Gjatë punimeve punëkryesi është i obliguar të vendos shenjat për punime në rrugë dhe organizimin e trafikut.

E punoi:
Arian Teneqja